



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr.11 , Datë, 20.01.2021

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GERTI” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 germa “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1 germa “e”, nenit 10 pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 19 pika 1, germa “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 9/5 prot, datë 15.01.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “GERTI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 5 prot, datë 06.01.2021, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,
- Shoqëria “GERTI” sh.p.k., është regjistruar pranë QKB-së në datën 17.03.2000 konform Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën kombëtare e Biznesit” (QKB) me statusin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (shpk).
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për tu pajisur me licencë nga ERE, ne zbatim te Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.
- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “GERTI” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim, Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”, **plotësuar.**
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2, gërmat “c”, “e”, **plotësuar;**
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal., Neni 9, pika 3, gërmat “b”, “d”, **plotësuar;**
- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

#### **Nenin 9, pika 2, Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor;**

- **germa “a”/“b”** (akti i themelimit/statuti), **Pa plotësuar.** Shoqëria “GERTI” sh.p.k., në vijim do të depozitojë Aktin e themelimit dhe Statutin e saj në ERE.
- **germa “d”** (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). **Plotësuar pjesërisht.** Sa konstatuar në ekstraktin e QKB-se shoqëria veprimtarinë e saj e ushtron edhe në zonën e Librazhdit (zona ku do të zhvillohet projekti IHEC-it Vardari). Si e tillë, kjo shoqëri përveç vërtetimeve të gjendjes gjyqësore të lëshuara nga qarku i Dibrës (ku ndodhet selia kryesore e saj), duhet të përcjellë në ERE edhe ato të qarkut të Elbasanit.  
Në vijim shoqëria do të depozitojë në ERE Vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë së Qarkut Dibër për administratorin e saj dhe Vërtetimet e gjykatës dhe Prokurorisë së qarkut Elbasan, për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj.

#### **Neni 9, pika 3, Dokumentacioni financiar dhe fiskal;**

- **germa “a”** (vërtetimi për shlyerjen e tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj institucionit të Sigurimeve shoqërore). **Plotësuar pjesërisht.** Shoqëria ne vijim do të përcjellë në ERE vërtetimin në lidhje me sigurimet shëndetësore dhe shoqërore.
- **germa “c”** (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj), **Plotësuar pjesërisht.** Duke qënë se kjo shoqëri është aplikante edhe për prodhimin e energjisë elektrike, do ti kërkohet të specifikojë kapitalin financiar që dedikon për tregtimin e energjisë elektrike.

#### **Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, Neni 9, pika 4.8,**

- gërmat “a”/“d” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar në GWh / sipas viteve);
- gërma “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti);
- gërma “c” (Lista e kontratave të mëparshme, nëse ka pasur),

do të njoftohet subjekti që në bazë të neneve 10, pika 10 dhe 11 të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5- vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.